

Në mbështetje të nenit 6, paragrafi 6.2, pika 2, paragrafi 6.7, nenit 7, paragrafi 7.4 dhe 7.4.1 pika 5, paragrafi 7.4.2, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores Disiplinore të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), Komisioni Disiplinor i FVK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

1. KV Skënderbeu, në cilësinë e organizatorit të ndeshjes, për shkelje të dispozitave të Rregullores Disiplinore të FVK-së - Shpallet përgjegjës.
2. KV Skënderbeu dënohet me gjobë financiare, në lartësi prej 300 euro në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores Disiplinore të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor, në formë elektronike, me datë 24.03.2026, përmes shërbimeve të sekretarisë, ka pranuar Vendimin e z. Fadil Lumi, Komesar i Garave të FVK-së, për iniciimin e procedurës disiplinore lidhur ndaj KV Skënderbeu në cilësinë e organizatorit të ndeshjes në mes të KV Skënderbeu – KV Luboteni, e zhvilluar më 18.03.2026. Së bashku me vendimin përkatës, Komisioni ka pranuar edhe dokumentacionin relevant që është pjesë përbërëse të dosjes së lëndës, përfshirë raportin zyrtar të delegatit, deklaratat e gjyqtarëve, si dhe deklaratat e KV Skënderbeu dhe KV Luboteni.

Komisioni Disiplinor ka mbajtur mbledhjen e parë në formë elektronike me datë 26.03.2026, me fillim nga ora 17:00, në të cilën kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e Komisionit (1. Fidan Hamiti, kryetar, 2. Gani Beqiri, anëtar dhe 3. Liridon Dalipi, anëtar), si dhe Sekretari i Përgjithshëm i FVK-së, z. Valon Nikqi. Në këtë mbledhje, pas shqyrtimit fillestar të dosjes së lëndës, Komisioni, në përputhje me parimin e dëgjimit të të gjitha palëve, ka vendosur të kërkojë nga KV Skënderbeu që të paraqesë deklaratë me shkrim lidhur me incidentin në fjalë respektivisht pretendimet e ngritura.

Përmes shërbimeve të sekretarisë, kjo kërkesë i është përcjellë përfaqësuesve të KV Skënderbeu, ndërsa deklarata me shkrim e klubit është pranuar dhe është marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit të çështjes.

Pas pranimit të deklaratës, pranuar më 30.03.2026, Komisioni ka bërë administrimin e plotë të provave, duke vlerësuar të gjitha shkresat dhe dëshmitë relevante në dosjen e lëndës.

Në vijim, Komisioni ka realizuar edhe mbledhjen e dytë zyrtare, me qëllim mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor për rastin në fjalë dhe ka ardhur në:

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të gjithanshëm të provave të administruara, përfshirë raportin zyrtar të delegatit, deklaratat e gjyqtarëve, si dhe deklaratën me shkrim të paraqitur nga KV Skënderbeu, Komisioni Disiplinor vlerëson se në ndeshjen KV Skënderbeu – KV Luboteni, e zhvilluar më 18.03.2026, kanë ndodhur incidente që gjatë zhvillimit të ndeshjes, një grup shikuesish kanë përdorur fjalor ofendues ndaj ekipit mysafi, duke hedhur mjete të forta në fushë (përfshirë vezë dhe petarda), me ç'rast është goditur një lojtar i ekipit mysafir, ku si rezultat i këtyre veprimeve, ndeshja është ndërprerë përkohësisht.

Nga leximi I të gjitha provave vihet re se organizimi i ndeshjes nga ana e klubit vendas nuk ka qenë në nivelin e kërkuar, veçanërisht në aspektin e sigurisë dhe kontrollit të shikuesve, ku edhe ndeshja ka filluar pa prezencën e organeve të sigurisë, çka paraqet mangësi serioze organizative.

Komisioni vlerëson se, pavarësisht faktit që KV Skënderbeu ka ndërmarrë veprime pas incidentit, përfshirë reagimin për rikthimin e normalitetit, ka bashkëpunuar gjatë procedurës dhe ka paraqitur kërkimfalje, këto veprime mund të merren si rrethana lehtësuese në kuptim të nenit 3 të Rregullores. Megjithatë, këto rrethana nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e tij si organizator i ndeshjes për garantimin e rendit dhe sigurisë, si dhe për mbarëvajtjen e rregullt të saj, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga rregulloret në fuqi. Komisioni vlerëson se, pavarësisht faktit që KV Skënderbeu ka ndërmarrë veprime pas incidentit, përfshirë reagimin për rikthimin e normalitetit, ka bashkëpunuar gjatë procedurës dhe ka paraqitur kërkimfalje, këto veprime mund të merren si rrethana lehtësuese në kuptim të nenit 3 të Rregullores.

Megjithatë, këto rrethana nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e tij si organizator i ndeshjes për garantimin e rendit dhe sigurisë, si dhe për mbarëvajtjen e rregullt të saj, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga rregulloret në fuqi.

Në këtë kuptim, në funksion të parandalimit të rasteve të ngjashme në të ardhmen, Komisioni Disiplinor i rekomandon KV Skënderbeu që të sigurojë prezencën e organeve të sigurisë para fillimit të çdo ndeshjeje, të ndërmarrë masa shtesë organizative për garantimin e rendit dhe sigurisë në palestër, të rrisë kontrollin dhe të parandalojë hyrjen e personave që cenojnë mbarëvajtjen e ndeshjeve.

Andaj, në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të lartcekura, si dhe në përputhje me dispozitat e Rregullores Disiplinore FVK-së, Komisioni Disiplinor i FVK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR :



Gani Beqiri, anëtar



Fidan Hamiti, kryetar



Liridon Dalipi, anëtar

Prishtinë, 15.04.2026



Vendimi t'u dërgohet:

- KV Skenderbeu,
- Komesarit të Garave,
- Zyrtarëve të ndeshjes përkatëse,
- Anëtarëve të FVK-së,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FVK-së dhe
- Arkivit të FVK-së.

**KËSHILLË
JURIDIKE:**

Konform Nenit 12 paragrafi 12.1 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në Komisionin e Ankesave në afat prej 15 ditësh, kundrejt pagesës prej 300 euro.